

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE PRANË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGËTISË DHE SIPËRMARRJES

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike Pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, me objekt “Mbi derdhjen e dividendit nga shoqëritë anonime të përbashkëta që kanë dalë me fitim në vitet 2012-2013 dhe zbatimin e ligjshmërisë në emërimin e antarëve të Këshillit Mbikëqyrës”, për periudhën 01.01.2012 deri 31.12.2013, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 179, date 23.12.2014

Në mbështetje të nenit 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 8511/6, datë 24.12.2014, dërguar z. Arben Ahmetaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtëme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1. Nga auditimi i miratimit të llogarive vjetore të shoqërive sha u konstatua se, shumë shoqëri (sha) kanë **mungesë aktiviteti dhe paaftësie paguese**, shumë prej tyre kanë pa paguar detyrimet për paga dhe sigurime shoqërore të ish punonjësve dhe punonjësve aktuale, si dhe detyrime të tjera të pasqyruara në llogaritë vjetore të tyre. Konstatohet gjithashtu se detyrimet për paga dhe sigurime shoqërore të “Ndërmarrjes ish Kombinati i Tekstileve” Tiranë, “Ndërmarrja Uzina Mekanike e Tekstilit” Tiranë dhe Ndërmarrja “Goma” Durrës, të cilat janë në proces privatizimi, kanë ngelur pa u likuiduar duke krijuar probleme të mprehta sociale. Ndërkohë sipas VKM nr. 428, datë 09.06.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, kap. III “Procedura e shitjes së pronës shtetërore”, pika 25, theksohet setë ardhurat nga privatizimi i aseteve të ndërmarrjeve, i kalojnë 65% buxhetit të shtetit, 30% Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes dhe 5% Ministrisë së Financave”, trajtuar më hollësisht në faqet 35-61 të raportit.

Për këtë është rekomanduar që:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes & Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Financave, të përgatisë dhe ndjekë miratimin e një VKM të re, në të cilën të përcaktohet:

a. Një pjesë e të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjeve apo shoqërive shtetërore, të përdoret për përballimin e shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, apo detyrime tatimore të prapambetua, me qëllim lehtësimin e problematikave sociale dhe përshpejtimin e privatizimit të tyre.

b. Për shoqëritë (sha) në likuidim, apo privatizim **të bëhet një formë organizimi rajonal**, për të mundësuar uljen e shpenzimeve operative, nëpërmjet bashkimit të disa ndërmarrjeve dhe shoqërive, apo kalimit në administrim të aseteve të disa shoqërive në një shoqëri të vetme, sipas natyrës apo industrive ku veprojnë.

Brenda 6/mujorit të parë të vitit 2015.

2. Nga auditimi në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, mbi auditimin e zbatimit të dispozitave ligjore për emërimin, ndryshimin e Këshillave Mbikëqyrës, rezultoi se:

a. Nuk janë respektuar **strukturat e këshillave mbikëqyrëse**, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10264, datë 08.04.2010 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”;

b. Nuk është respektuar, në 8 shoqëri, **numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrëse** të parashikuar sipas sektorëve strategjikë (me 6 antarë të këshillave mbikëqyrës) dhe jo strategjikë (me 3 antarë), në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, i ndryshuar, me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, i ndryshuar, si dhe me Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”;

c. Në disa raste janë përllogaritur gabim shpërblimet për pjesëmarrje të antarëve të Këshillave Mbikëqyrës për shkak të **formulës së komplikuar** të pagesave të tyre, dhe të ndryshimeve të herpashershme në legjislacionin mbi të cilët mbështetet VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të sha-ve”, i ndryshuar.

d. Nga auditimi u konstatua se, në 6 shoqëri anonime janë emëruar anëtarë me afat emërimi më shumë se 3 vite, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

e. Nga auditimi rezultuan 3 shoqëri anonime, të cilat nuk kanë asnjë të dhënë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe 6 shoqëri të tjera të cilat nuk kanë **azhurnuar ndryshimet**, në kundërshtim me kërkesat nenit 22, të ligjit nr. 9773, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. **Për këtë është rekomanduar që:**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes & Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Financave, të përgatisë dhe ndjekë miratimin e **një VKM të re**, me qëllim rritjen e efikasitetit të punës të këshillave mbikëqyrëse, duke e larguar vendimmarrjen e tyre nga formaliteti dhe duke rritur përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e çdo anëtarë në vendimmarrje. Në këtë VKM të përcaktohen qartë: **strukturat e këshillave mbikëqyrëse, numri i anëtarëve** të këshillave mbikëqyrëse bazuar në madhësinë e shoqërisë, sektorit ku operon, por dhe mënyrës së përzgjedhjes duke synuar në përfshirjen e ekspertëve të fushave respektive në këto këshilla por dhe **kriteret e përcaktimit të shpërblimeve për** antarët e Këshillave Mbikëqyrëse.

Gjithashtu në këtë VKM të përcaktohen qartë, detyrimi dhe përgjegjësia e shoqërive dhe e strukturave që i monitorojnë ato, **për të reflektuar në kohë gjithë ndryshimet në të dhënat e shoqërive (sha)**, me qëllim rritjen e transparencës dhe përdorimin efektiv të këtij informacioni nga grupet e interesit.

Brenda 6/mujorit të parë të vitit 2015.

3. Nisur nga mënyra e emërimit të ekspertëve kontabël pa procedura konkurruese dhe transparente, e gjykojmë të nevojshme që të ndërhyhet edhe në mënyrën e përzgjedhjes së ekspertëve kontabël, apo shoqërive audituese, që certifikojnë pasqyrat financiare të shoqërive me pronësi shtetërore, duke synuar hartimin dhe shpalljen e rregullave e kriterëve, në lidhje me eksperiencën, kompetencën profesionale dhe integritetin shoqëror të ekspertëve kontabël.

Brenda 6/mujorit të parë të vitit 2015.

B.MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i llogaritjes, miratimit dhe derdhjes së dividendit për shoqërinë sha “**Albpetroli**” **Patos**, rezultoi se nga dividendi i miratuar, kjo shoqëri ka për të derdhur për llogari të Ministrisë

së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, vlerën prej **2,712,802,377 lekë**, të ndara me periudha si më poshtë:

- Nga detyrimi i dividendit **për vitin 2011**, të miratuar për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në vlerë 3,097,595 mijë lekë, është derdhur vetëm vlera prej 497,595 mijë lekë, në datën 23.01.2014. Ka ngelur pa u derdhur për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, vlera e dividendit prej **2,600,000 mijë lekë**. Për këtë vit, fitimi i realizuar nga kjo shoqëri, miratuar nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike ka rezultuar në vlerën 3,441,773 mijë lekë. Dividendi i miratuar për t'u derdhur këtë vit, është miratuar në masën 100% e fitimit të realizuar pra 3,441,773 mijë lekë (i ndarë 344,177 mijë lekë për llogari të degës së tatim taksave dhe 3,097,595 mijë lekë për t'u derdhur për llogari të MZHETS). Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike e justifikon miratimin e shpërndarjes së fitimit në këto kuota me faktin se, shoqëria sha "Albpetroli" Patos, do të privatizohet dhe nuk kishte pse krijonte "rezerva zhvillimi" apo "rezerva ligjore", si në vitet e tjera, por gjithë fitimi të derdhej në buxhetin e shtetit.

Vlera prej 344,177 mijë lekë është derdhur e plotë, për llogari të degës së tatim taksave, kurse për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, është derdhur vetëm 497,595 mijë lekë në datën 23.01.2014, ose sa **16%** e vlerës së miratuar të dividendit, apo fitimit të realizuar.

-Detyrimi i dividendit për t'u derdhur **në vitin 2012**, në vlerë 288,570,369 lekë është derdhur plotësisht në vitin 2014.

-Detyrimi i dividendit për t'u derdhur, i miratuar për **vitin 2013**, është derdhur vetëm pjesa e dividendit për llogari të degës së tatim taksave, kurse pjesa e dividendit e miratuar për llogari të ministrisë, në vlerë **112,802,377 lekë**, deri në periudhën e auditimit nga ne, nuk është derdhur, trajtuar më hollësisht në faqet 35-61 të raportit. **Për këtë është rekomanduar që:**

a. Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, **të marrë masa për të siguruar arkëtimin e detyrimit të dividendit të miratuar në vitin 2011** për shoqërinë "Albpetroli" sh.a Patos, në vlerë **2,600,000,000 lekë**. Vendimarrja për shpërndarjen e fitimit të mos jetë e varur nga proceset e privatizimit, por të udhëhiqet nga analiza për nivelin e investimeve dhe planet e zhvillimit që i paraprijnë këtij procesi vendimmarrës.

b. Të merren masa që të derdhet për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, detyrimi i dividendit të miratuar për vitin 2013, në vlerë **112,802,377 lekë**.

Brenda 6/mujorit të parë të vitit 2015

2. Nga auditimi i llogaritjes, miratimit dhe derdhjes së dividendit për shoqërinë sha **"Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë (OST)" Tiranë** rezultoi se kjo shoqëri, pavarësisht se llogaritë vjetore të saj rezultojnë me fitim çdo vit, gjendja e saj financiare dhe aftësia e saj paguese është e vështirë, dhe si rezultat ka dividend të miratuar për t'u derdhur për llogari të MZHETS, në vlerë **468,760,149 lekë**, të ndara në vite kështu:

-Detyrimi i dividendit të pa derdhur për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për vitin 2011, është 125,523,384 lekë;

-Detyrimi i dividendit të pa derdhur për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për vitin 2012, është 202,411,951 lekë;

-Detyrimi i dividendit të pa derdhur për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për vitin 2013, është 140,824,814 lekë. **Për këtë është rekomanduar që:**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes & Ministria e Energjisë dhe Industrisë, analizojë pasqyrat financiare dhe vërtetësinë e tyre për shoqërinë **"Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë (OST)" sha Tiranë**.

Të nxirren mbi bazën e një analize financiare të thelluar të faktorëve që kanë ndikuar në gjendjen e paaftësisë paguese, si dhe të jepen detyra të qarta këshillit mbikëqyrës për të përcaktuar hapat konkretë për përmirësimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë.

Të kërkojë nga strukturat drejtuese të shoqërisë një skedul të qartë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të dividendit në vlerë **468,760,149 lekë**.

Brenda 6/mujorit të parë të vitit 2015

3. Nga auditimi i llogaritjes, miratimit dhe derdhjes së dividendit për shoqërinë **“Korporata Elektroenergjitike Shqiptare”(KESH), Tiranë**, rezultoi se kjo shoqëri, pavarësisht se llogaritë vjetore të saj rezultojnë me fitim çdo vit, ka një gjendje financiare dhe paguese të vështirë, dhe si rezultat, ka pa derdhur detyrime të dividendit të miratuar gjithsej në vlerë **2,451,885,639 lekë**, (i ndarë 345,188,564 lekë për llogari të degës së tatim taksave dhe 2,106,697,075 lekë për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes).

Në arsyet e mos likuidimit të dividendit dhe të detyrimeve të tjera nga kjo shoqëri, Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike veçon, mos likuidimin e detyrimeve nga ana e OSHEE (më parë CEZ shpërndarje). Niveli i pagesave nga OSHEE, për detyrimet e papaguara ndaj KESH - sha janë në masë në 45% të tyre, pra shoqëria OSHEE është debitore ndaj KESH sha për afro 57 miliardë lekë. Për këtë arsye KESH sha është detyruar të marrë kredi në formën e Overdraftit, për të cilat paguan interesa të larta. Gjithashtu KESH sha blen energji nga HEC-et private me vlerë 9.3 lekë/kh dhe shitjet e energjisë shoqërisë OSHEE, ja faturon me vlerë 2.2 lek/kwh.

Të ndara në vite detyrimet e pa derdhura të dividendit nga KESH, janë:

-Detyrimi i trashëguar dhe i pa derdhur nga viti 2004, është 537,874,939 lekë (53,787,494 lekë për llogari të degës së tatim taksave dhe 484,087,445 lekë për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes);

-Detyrim i pa derdhur i vitit 2012, për 644,006,700 lekë (64,400,670 lekë për degën e tatim taksave dhe 579,606,030 lekë për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;

-Detyrim i pa derdhur i vitit 2013, për 1,270,004,000 lekë (127,000,400lekë për degën e tatim taksave dhe 1,143,003,600 lekë për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes), trajtuar më hollësisht në faqet 35-61 të raportit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes & Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të analizojë pasqyrat financiare dhe vërtetësinë e tyre për shoqërinë **“Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare”(KESH), Tiranë**.

Të nxirren, mbi bazë të një analize financiare të thelluar, faktorët që kanë ndikuar në gjendjen e paaftësisë paguese, si dhe t'i jepen detyra të qarta këshillit mbikëqyrës, për të përcaktuar hapat konkretë për përmirësimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë si dhe të kërkojë një skedul të qartë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të dividendit prej **2,451,885,639 lekë**.

Brenda 6/mujorit të parë të vitit 2015

4. Nga auditimi i llogaritjes, miratimit dhe derdhjes së dividendit për shoqërinë **sha “Hec Ulëz-Shkopet” Burrel** (tani e privatizuar), rezultoi se, ka për të derdhur dividend për llogari të të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në vlerë **66,065,035 lekë**, detyrim i pa derdhur i vitit 2012, i llogaritur dhe i miratuar në masën 95% e fitimit. Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike veçon se, arsyeja e mos likuidimit të dividendit, është privatizimi i sa. Shoqëria blerëse e sha “Hec Ulëz-Shkopet” Burrel, e bleu atë me të gjithë të drejtat dhe detyrimet, pra edhe me detyrimin e derdhjes së dividendit, trajtuar më hollësisht në faqet 35-61 të raportit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për detyrimin e dividendit të miratuar për t'u derdhur nga bilanci i llogarive vjetore të vitit 2012, në vlerë **66,065,035 lekë**,

detyrim i pa derdhur për llogari të ministrisë nga ish shoqëria **sha “Hec Ulëz-Shkopet” Burrel** (tani e privatizuar), të nxjerrë përgjegjësitë e strukturave institucionale për mosplotësimin e këtij detyrimi.

Të ndërmerren veprimet e nevojshme për plotësimin e detyrimit të shumës së dividendit të pa derdhur nga subjekti blerës, për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Brenda vitit 2015.

5. Nga auditimi i llogaritjes, miratimit dhe derdhjes së dividendit për shoqërinë **sha “Alba film” Tiranë**, rezultoi se, ka për të derdhur dividend për llogari të MZHETS, në vlerë **6,533,305 lekë**. Në raportin e audituesve të pavarur (të ekspertëve kontabël) është përcaktuar kështu gjendja e llogarive financiare: për vitin 2012 “Pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të shoqërisë, më datë 31 dhjetor 2012, si dhe të rezultateve të veprimtarive të saj për ushtrimin e mbyllur, në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar” dhe për vitin 2013: Nuk ka raport të firmosur nga audituesit e pavarur, por vetëm është shkruar mbi pasqyrat financiare “, që këto janë audituar nga ekspertët.

Detyrimet e pa derdhura të dividendit të ndara në vite janë :

-Detyrimi i dividendit të pa derdhur për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për vitin 2011, është 2,207,135 lekë;

-Detyrimi i dividendit të pa derdhur për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për vitin 2012, është 2,626,420 lekë;

-Detyrimi i dividendit të pa derdhur për llogari të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për vitin 2013, është 1,699,750 lekë. Kjo shoqëri është në pritje të shitjes së objektit të mbetur, trajtuar më hollësisht në faqen 35-61 të raportit.

Për këtë është rekomanduar që:

Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes), të nxjerrë përgjegjësitë e strukturave drejtuese të shoqërisë të **sha “Alba film” Tiranë për** mosplotësimin e këtij detyrimi në kohë dhe të marrë masa për derdhjen e tij, në vlerën **6,533,305 lekë** si dhe të analizojë punën e ekspertëve kontabël të autorizuar për mënyrën e realizimit të misionit të tyre të auditimit.

Brenda vitit 2015.

6. Nga auditimi i miratimit të llogarive vjetore të shoqërive (sha) me kapital 100% shtetëror, për vitet 2012 dhe 2013, nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, kanë rezultuar:

a. Disa shoqëri (sha) si: “Korporata Elektro-energjetike Shqiptare (KESH)”, Tiranë, “Alpetrol” Patos, “Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë (OST)” Tiranë, në çdo vit ushtrimor megjithëse rezultojnë **me fitim, janë në gjendje të vështirë financiare**, pra në vështirësi për të likuiduar detyrimet e dividendit dhe detyrimet e tjera financiare që ka shoqëria me klientët, me bankat dhe me punonjësit. Në llogarinë vjetore të tyre, nuk ka një analizë të hollësishme për të ardhurat dhe shpenzimet, si nga strukturat drejtuese e financiare të shoqërive, ashtu edhe nga ekspertët e autorizuar kontabël të tyre, për të shpjeguar gjendjen financiare në të cilën ndodhen.

b. Në një pjesë të konsiderueshme të llogarive vjetore të shoqërive (sha) kanë rezultuar me ndryshime të theksuara të rezultatit nga njëri vit në tjetrin, pa një sqarim të qartë të pozicioneve të llogarive, si nga strukturat financiare të shoqërive, ashtu edhe nga raportet e audituesve të pavarur (ekspertëve kontabël), si më poshtë:

Për vitin 2012, kanë rezultuar me humbje 11 shoqëri dhe një vit më parë kanë rezultuar me fitim, apo me humbje më të ulët. Nga strukturat drejtuese e menazhuese të këtyre shoqërive, por edhe nga Këshillat mbikëqyrës dhe ekspertët kontabël, të cilët miratojnë dhe auditojnë llogaritë dhe aktivitetin ekonomik të tyre, nuk jepen sqarime të qarta se pse kanë rezultuar kështu këto shoqëri nga viti në vit, si:

“Trajtimi i Studentëve Gjirokastër” sh.a, ka rezultuar dhe i janë miratuar llogaritë vjetore me humbje për vitin 2012, në vlerë 6,511,223 lekë, nga 893,891 lekë rezultuar dhe miratuar në vitin 2011, pra humbja e vitit 2012 ka rezultuar 7.3 herë më e madhe se një vit më parë.

Opinion i ekspertëve kontabël rezulton në këtë përcaktim: “Megjithëse Drejtori dhe K/Financiar ka nënshkruar deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare në kohë, entitetit nuk ka dorëzuar akoma pasqyrat financiare të mbyllura deri më 31 janar 2012 në institucionet METE, QKR dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve. Meqenëse kjo shoqëri nuk ka implementuar një Sistem Kontabël Informatikë, një Sistem Faturash Shitje dhe gjithëpërfshirës, ekziston një pasiguri lidhur me plotësinë e arkëtimeve dhe aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, për të deklaruar një raport të saktë të ardhurave dhe për të monitoruar arkëtimet e kryera në kohë”. Po me këtë opinion këshilli mbikëqyrës i kësaj shoqërie ka miratuar llogarinë vjetore të vitit 2012 dhe ja ka përcjellë atë MZHETS- Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike.

“Kombinati Energjitik Elbasan” sh.a, ka rezultuar dhe i janë miratuar llogaritë vjetore me humbje për vitin 2012, në vlerë 201,675,928 lekë, nga 48,681 lekë rezultuar dhe miratuar në vitin 2011, pra humbja e vitit 2012 ka rezultuar 400 herë më e madhe se një vit më parë.

Opinion i ekspertëve kontabël rezulton në këtë përcaktim: “...Tërhiqet vëmendje se pavarësisht faktit se drejtimi nuk ka për qëllimin ndërprerjen e aktivitetit, mund të ekzistojë arsye për mosplotësimin e kushtit të vijimësisë, pasi veprimtaria e shoqërisë deri në ditët e sotme bazohet në zhvillimin jonormal të aktivitetit, gjë që mund të ketë ndikim në vlerësimin e zërave të ndryshëm të pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të shoqërisë, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj të parave për vitin e mbyllur 2012 në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”. Po me këtë opinion këshilli mbikëqyrës i kësaj shoqërie ka miratuar llogarinë vjetore të vitit 2012 dhe ja ka përcjellë atë MZHETS- Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike.

Kështu vazhdohet edhe me shoqëritë e tjera që rezultojnë me diferenca nga viti në vit i rezultatit financiar.

Për vitin 2013, kanë rezultuar me humbje shumë më të lartë se një vit më parë, 7 shoqëri sha dhe nga strukturat drejtuese e menazhuese të këtyre shoqërive, por edhe nga Këshillat mbikëqyrës dhe ekspertët kontabël, të cilët miratojnë dhe auditojnë llogaritë dhe aktivitetin ekonomik të tyre, nuk jepen sqarime të qarta se pse kanë rezultuar kështu këto shoqëri nga viti në vit, si:

“Posta Shqiptare” sh.a ka rezultuar dhe i janë miratuar llogaritë vjetore me humbje për vitin 2013, në vlerë 24,492,118 lekë, nga 73,004,768 lekë rezultuar dhe miratuar me fitim në vitin 2012, pra humbja e vitit 2012 ka rezultuar 4 herë më e madhe se rezultati i një viti më parë.

Opinion i ekspertëve kontabël rezulton në këtë përcaktim: “Shoqëria ka bërë rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale në datë 31.12.2012 dhe efekti i rivlerësimit të tyre është paraqitur në bilancin e vitit që përfundoi më 31.1.2013. Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale nuk është miratuar nga pronari (ministria e MZHETS). Posta Shqiptare ka realizuar një investim për kryerjen e veprimtarive lidhur me teknologjinë e informacionit nëpërmjet njësisë Interpost. Për qëllim të ruajtjes së performancës së veprimtarive të vijimësisë, shoqëria ka adaptuar një politikë kontabël të paraqitjes së kostove përkatëse, të cilat janë njohur përkatësisht si në pasqyrat financiare të konsoliduara. Nuk janë në gjendje të binden për vijimësinë në mënyrën e kthimit të investimit. Mos marrja pjesë gjatë procesit të inventarizimit fizik të gjendjeve të inventarit të deklaruar në një vlerë totale 184,019,853 lekë më 31.12.2013. Gjatë vitit 2013, Shoqëria “Interposta” sh.p.k ka realizuar shitje kundrejt institucioneve buxhetore (komuna, DAR) për shumën prej 53,516,198 lekë, për të cilat është e pa qartë me çfarë fondesh është kryer financimi i tyre. Pasqyrat financiare të konsoliduar të Shoqërisë “Posta Shqiptare” sha në datën 31 Dhjetor 2012, janë audituar nga auditues të tjerë, të cilët kanë shprehur opinion të kualifikuar në datë 14.05.2013. *Me përjashtim të efekteve të mundshme të rregullimeve sipas çështjeve të referuar në paragrafët më lartë, pasqyrat financiare të konsoliduar japin një pamje të vërtetë dhe të besueshme të gjendjes financiare të grupit Posta Shqiptare sh.a, më datë 31.12.2013”.*

Po me këtë opinion këshilli mbikëqyrës i kësaj shoqërie ka miratuar llogarinë vjetore të vitit 2013, dhe ja ka përcjellë atë të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike, pa shpjeguar nga kjo shoqëri se si një vit më parë rezultoi me fitim 73 milion lekë dhe këtë vit del me humbje prej 24.5 milion lekësh, pra me një diferencë rezultati nga viti në vit prej 97.5 milion lekë.

“Ndërmarrja Trajtimit Studentëve nr.2” sh.a Tiranë, ka rezultuar dhe i janë miratuar llogaritë vjetore me humbje në vitin 2013 për 12,557,372 lekë nga 7,072,154 lekë në vitin 2012, ose 1.8 herë më shumë se një vit më parë.

Opinionin me Rezervë i ekspertëve kontabël rezultoi në këtë përcaktim: “Për mos pjesëmarrje gjatë procesit të inventarizimit fizik të gjendjeve të inventarit të AAM deklaruar në një vlerë totale 755,009,577 lekë më 31.12.2013, sepse kjo datë ishte para angazhimit si auditues të shoqërisë, por njohja me komisionin e kryerjes së inventarëve në fund të vitit si dhe me materialet e inventarizimit të cilat japin përshtypjen e një procesi të rregullt inventarizimi”. Po me këtë opinion këshilli mbikëqyrës i kësaj shoqërie ka miratuar llogarinë vjetore të vitit 2013 dhe ja ka përcjellë atë të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike, trajtuar më hollësisht në faqet 35-61 të raportit.

Për këtë është rekomanduar që:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes/Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërive, **të kërkojë për llogaritë vjetore** të çdo viti, nga:

a. Organet drejtuese të shoqërive (sha), të rrisin përgjegjshmërinë në momentin e miratimit të pasqyrave financiare, moment i cili nuk mund të jetë një vendimarrje formale, pasi janë Këshillat e Mbikëqyrjes përgjegjës për rezultatin e aktivitetit dhe vërtetësinë e pasqyrimit të tij në pasqyrat financiare. Vendimarrja duhet të shoqërohet nga një **raport i hollësishëm për shpjegimin e pasqyrave financiare vjetore, i cili duhet të shoqërojë** llogarinë vjetore që dorëzohet në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike në Ministrinë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

b. Për ekspertizën e llogarive vjetore të shoqërive (sha), të vendosë në **marrëveshjen** e lidhur midis eksperteve të autorizuar kontabël dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si pronar i vetëm i këtyre shoqërive, që në fund të ekspertizës kontabël, në përmbushje të misionit të marrin përsipër të dorëzojnë në këtë ministri, përveç raportit standard të auditimit edhe “letrën e menaxhimit” (EKR), për pasqyrat financiare vjetore dhe sugjerimet e tyre për shoqëritë me vështirësi *financiare*, si “Korporata Elektro-energjetike Shqiptare (KESH)”, Tiranë, “Alpetrol” Patos sha, “Alba film” Tiranë dhe “Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë (OST)” Tiranë, apo edhe shoqëritë sha *me ndryshime të mëdha të rezultatit* nga njeri vit në tjetrin, të mund të gjejnë rrugët dhe mundësitë si dhe të adresojnë përgjegjësitë, për të dalë nga kjo gjendje.

Brenda 3/mujorit të parë të vitit 2015.

7. Nga auditimi i miratimit të llogarive vjetore të viteve 2012 dhe 2013 të shoqërive (SHA) me kapital 100% shtetëror, rezultuan të miratuara nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike dhe të firmosura nga Ministri, megjithatë:

Për vitin 2012, nuk janë të miratuara llogaritë vjetore të 5 shoqërive (sha):

“Kripa” Vlorë & “Trajtimi i Studenteve Vlorë”, sepse ngelën pa u firmosur nga Ministri i mëparshëm në momentin e ndërrimit të qeverive;

“Albturist TO”, Tiranë, “Këpuca Korçë” & “Trikotazhi” Korçë, sepse nuk janë zbatuar sugjerimet e lëna nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike. Për këto shoqëri është njoftuar Ministri disa herë, i cili ka proceduar me shkarkimin e Administratorëve, apo edhe të organeve Drejtuese të shoqërisë.

Për vitin 2013, nuk janë të miratuara llogaritë vjetore të 6 shoqërive (sha):

“Albminiera” Tiranë & “Kripa” Vlorë, sepse shoqëritë kishin ngelur pa administrator prej 1 vit e gjysmë dhe një muaj më parë janë emëruar administratorët e rinj;

“Këpuca Korçë”, sepse do bëhet bashkimi me përthithje me shoqërinë *“Trikotazhi” Korçë*;

“Berateks” Berat, sepse llogaria vjetore është pa miratim të ekspertëve kontabël dhe pa miratim të këshillit mbikëqyrës. Kjo ministri ka kërkuar disa herë tek ministria e linjës administrative për kalimin e kësaj shoqërie në likuidim;

“Kombinati Energjetik” Elbasan, është miratuar me vonesë sepse kjo shoqëri, në bazë të informacioneve dërguar ministrit, duhet të kalojë në likuidim dhe deri tani për këtë shoqëri nuk ka kthyer përgjigje ministria e linjës;

“Albturist-TO”, Tiranë, nuk është miratuar, sepse nuk janë zbatuar sugjerimet e lëna nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, trajtuar më hollësisht në faqet 19-35 të raportit.

Për këtë është rekomanduar që:

Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, në bashkëpunim me këshillat mbikëqyrës të këtyre shoqërive, të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit, i cili do të mundësonte miratimin e këtyre llogarive vjetore, duke dhënë orientime të qarta se si do të realizohet ky proces likuidimi në mënyrë të shpejtë.

Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike në bashkëpunim me organet drejtuese të saj, të bashkëpunojë me ministrinë e linjës që, të jenë gati për likuidim shoqëritë (sha): *“Kripa” Vlorë*, *“Albturist TO” Tiranë*, *“Këpuca” Korçë & “Trikotazhi” Korçë*, *“Berateks” Berat*, *“Albminiera” Tiranë*.

Brenda 3/mujorit të parë të vitit 2015.

8. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes - Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, për shoqëritë me kapital 100% shtetëror, me probleme në administrim, në efektivitet dhe në likuidim, trajtuar më hollësisht në faqet 19-35 të raportit. Për këtë është rekomanduar që:

a. Të përgatisë një program, duke listuar të gjitha shoqëritë me problematikat e tyre, mënyrën dhe afatin kohor se kur parashikojnë zgjidhjen e problematikave, apo likuidimin e këtyre shoqërive, **brenda 6/mujorit të parë të vitit 2015.**

b. Sh.a “Agjencia Detare Taulantia” Durrës, të përfundojë likuidimin, **brenda 6/mujorit të parë të vitit 2015.**

c. “Ndërmarrja Frigoriferi nr.2 Yzberisht” Tiranë, të mbyllet objekti “Depo” e të kalojë në administrim të ndërmarrjes Industriale nr. 1 Tiranë, **brenda vitit 2014.**

d. Sh.a “Tipografia Ushtarake”, Tiranë, të shpallet në likuidim dhe të mbyllet, **brenda 6/mujorit të parë të vitit 2015.**

e. Sh.a “NPV Ushtarake”, Tiranë, të shpallet në likuidim dhe të mbyllet, **brenda 6/mujorit të parë të vitit 2015.**

9. Nga auditimi i miratimit të llogarive vjetore të 13 shoqëritë (SHA) me aksionar shtetin nën 100%, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, duke mos patur kuorumin e duhur për vendimmarrje për këto shoqëri, ka kërkuar mbledhjen e aksionarëve për privatizimin e kuotave të tyre. Shoqëria *“ARMO” Tiranë*, me pronar shtetin me 15% të aksioneve është në fazën e përlllogaritjes së paketës për punonjësit, ndërsa shoqëria *“Albtelekom” Tiranë*, me pronar shtetin me 16.8% të aksioneve, është publikuar disa herë privatizimi i kuotave shtetërore, por nuk ka patur kërkesa për blerje. Shoqëritë e tjera me pronar shtetin me përqindje të aksioneve nën 50%, janë në fazën e vlerësimit të paketës së aksioneve.

Për këtë është rekomanduar që:

a. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes/Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, të hartojë një program të detajuar të shoqërive (sha), për vlerësimin e paketës me pronar shtetin dhe në mundësinë e privatizimit të kapitalit shtetëror në to.

b. Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes ,të bashkëpunojë me eksperte të institucioneve ndërkombëtare për të kërkuar ekspertizën e tyre në vlerësimin e paketës shtetërore të aksioneve në ndërmarrjet strategjike, si dhe ngritjen e kapaciteteve në këtë drejtim, në mënyrë që, paketën e saj të aksioneve, ta vlerësojë me ekspertë të licencuar për vlerësim investimesh, si dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare për vlerësim aksionesh.

Brenda 6/mujorit të parë të vitit 2015.

10. Nga auditimi rezultoi se nga 19 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk) me pjesëmarrje aksionesh dhe shtetin shqiptar, 10 prej tyre janë në proces privatizimi, 2 janë në likuidim, dy prej tyre janë në sekuestro konservative, një në proces gjyqësor dhe 4 prej tyre vijojnë të punojnë normalisht. Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar (shpk), me kapital shtetëror nën 100%, janë krijuar kryesisht në vitet 1993-1996, disa prej tyre kanë pësuar dëmtime dhe kanë ndërprerë aktivitetin prej vitit 1997, janë në procese të gjata gjyqësore për pronësinë etj. Ndër vite, SHPK-të kanë paraqitur vështirësi në ushtrimin e aktivitetit dhe privatizimin e kuotave shtetërore të tyre. Në vitin 2014, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka nxjerrë urdhrat e privatizimit për të gjitha këto shoqëri dhe momentalisht janë në procedurë vlerësimi të kuotave, trajtuar më hollësisht në faqet 23-34 të raportit.

Për këtë rekomandoj:

a. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes/Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, **të hartojë një program të detajuar të shoqërive (shpk), për vlerësimin e paketës me pronar shtetin** dhe mundësinë e privatizimit të kapitalit shtetëror në to.

b. Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të bashkëpunojë me ekspertë të institucioneve ndërkombëtare për të kërkuar ekspertizën e tyre në vlerësimin e paketës shtetërore të aksioneve në ndërmarrjet strategjike, si dhe ngritjen e kapaciteteve në këtë drejtim, në mënyrë që paketën e saj të aksioneve, ta vlerësojë me ekspertë të licencuar për vlerësim investimesh, si dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare për vlerësim aksionesh.

Brenda 6/mujorit të parë të vitit 2015.

11. Janë lënë për zbatim, **në rekomandimet e mëparshme**, shpejtimi i likuidimit të shoqërive sha:

- “Shpërndarja e librit shkollor ” Tiranë, shoqëri në likuidim, me urdhrin e ministrit nr.373, datë 08.11.2004, rreth 10 vjet më parë;

- “Petroalba” sha, shpallur për likuidim me urdhër të ministrit nr. 975, datë 01.12.2011;

- “Albkrom” në likuidim, që çdo vit ka rezultuar me humbje dhe shpallur për likuidim me vendimin e gjykatës nr. 14014/5, datë 26.03.2004, të ndryshuar me vendimin nr. 14014/6, pra mbi 10 vjet më parë.

Në shoqëritë e mësipërme vazhdojnë të paguhen antarë të Këshillave Mbikëqyrës, roje etj. dhe vetëm pagesa e antarëve të Këshillave Mbikëqyrës për këto shoqëri për 10 vjet, është rreth 100 milion lekë. Megjithëse këto shoqëri kanë vazhduar shitjen e objekteve, nuk janë likuiduar akoma, për shkak të problematikave dhe pengesave nga Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) për regjistrimin e pronës, trajtuar më hollësisht në faqet 18-19 të raportit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në bashkëpunim dhe me Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), të marrin masa të menjëhershme për përfundimin e procesit të privatizimit të sha “Shpërndarja e librit shkollor “Tiranë, “Petroalba”, dhe sha “Albkrom”.

Brenda 3/mujorit të parë të vitit 2015.

12. U konstatua se, në 14 shoqëri (sha), **nuk janë respektuar strukturat** e këshillave mbikëqyrëse, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10264, datë 08.04.2010 “*Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”*, të ndryshuar”, ku përcaktohet se: “Anëtarët e këshillave mbikëqyrëse të

shoqërive aksionare shtetërore, i propozohen Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si më poshtë:

1/3 e anëtarëve propozohet nga Ministri i Financave;

1/3 e anëtarëve caktohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

1/3 e numrit të anëtarëve propozohet nga Ministria e Linjës Administrative apo nga organi i qeverisjes vendore, që përfaqëson shtetin, trajtuar më hollësisht në faqet 65-69 të raportit.

Për këtë është rekomanduar që:

Strukturat drejtuese të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike, të marrë masat e duhura për të rishikuar strukturat dhe anëtarësinë e këshillave mbikëqyrëse, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, për shoqëritë anonime:

SHA Këpuca, SHA ALBKONTROL, SHA ALBBAKER, SHA Qendra e Regjistrimit të Aksioneve, SHA Aeroporti Nënë Tereza, SHA Albafilm, SHA Duhan Cigare, SHA Tregtimi i librit artistik dhe shkencor, SHA Tregu me shumicë fruta perime Shkodër, SHA Tregu me shumicë fruta perime Vlorë, SHA NPV Ushtarake, SHA OST, SHA KESH, ALBPETROL SHA.

Brenda 3/mujorit të parë të vitit 2015

13. Nga auditimi rezultuan se, në 8 shoqëri anonime, numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrëse, nuk përkon me numrin e parashikuar sipas sektorit, në të cilin është përfshirë shoqëria e konkretisht:

1. Aeroporti Nënë Tereza SHA – 3 anëtarë.

2. Petrol Alba sha – 3 anëtarë.

3. Porti Shëngjin sha – 3 anëtarë.

4. Porti Vlorë sha – 3 anëtarë.

5. Porti Durrës sha – 3 anëtarë.

6. Porti Sarandë sha – 3 anëtarë.

7. Tregu me shumicë i fruta-perimeve, Shkodër – 6 anëtarë.

8. Tregu me shumicë i fruta-perimeve, Vlorë – 6 anëtarë.

Subjektet e renditura më sipër, për nga industria ku janë përfshirë duhen konsideruar si:

- sektorë strategjikë me rëndësi të veçantë për subjektet me numër rendor nga 1-6;

- sektorë jo strategjikë, për subjektet me numër rendor 7 & 8, duke iu referuar nenit 2, të ligjit nr. 8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, i ndryshuar. Në varësi të ndarjes sektoriale, duhet përcaktuar edhe numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrëse, mbështetur në kërkesat e VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore” ku përcaktohet qartë se numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrëse të shoqërive anonime është 3 (tre) anëtarë, për shoqëritë e vogla dhe të mesme dhe 6 (gjashtë) anëtarë për shoqëritë, që veprojnë në sektorët strategjikë me rëndësi të veçantë, trajtuar më hollësisht në faqet 65-69 të raportit.

Për këtë është rekomanduar që:

Shoqëritë anonime Aeroporti Nënë Tereza Tiranë, Petrol Alba sha, Porti Shëngjin sha, Porti Vlorë sha, Porti Durrës sha, Porti Sarandë sha, Tregu me Shumicë i Fruta-Perimeve, Shkodër, Tregu me Shumicë i Fruta-Perimeve, Vlorë, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të marrin masat e duhura për të rishikuar numrin e anëtarëve të këshillave mbikëqyrëse, në varësi të industrisë ku është përfshirë secila prej shoqërive anonime të mësipërme, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, i ndryshuar, VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, i ndryshuar, si dhe

Udhëzimit nr 318, datë 08.04.2009 *“Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”*.

Brenda 3/mujorit të parë të vitit 2015.

14. Nga auditimi u konstatua se, “Tregu i Shitjes me Shumicë i Fruta-Perimeve, Vlorë” dhe “Tregu i Shitjes me Shumicë i Fruta-Perimeve, Shkodër”, aktualisht operojnë me 6 anëtarë të këshillave mbikëqyrëse, të cilët duhet të shpërblehen për pjesëmarrje, në bazë të VKM nr. 642, datë 11.10.2005 *“Për Këshillat Mbikëqyrës të sha-ve”*, i ndryshuar, ku përcaktohet edhe shpërblimi për kryetarin dhe anëtarët, në varësi të sektorëve ku përfshihen shoqëritë si edhe varësisë nga pushteti qendror dhe/ose vendor. Gjithashtu, sipas vërtetimit që Sektori i Financës / MZHETS na ka vënë në dispozicion, rezulton se, pagat në bazë të së cilave kryhet edhe përlllogaritja e shpërblimeve të këshillave mbikëqyrëse janë: paga e Sekretarit të përgjithshëm në MZHETS, Drejtorit të Drejtorisë së administrimit të Pronës publike (DAPB) dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Prefekturës.

Kështu sa i takon aktivitetit të Sha “Tregu i shitjes me shumicë i fruta-perimeve, Shkodër” nga auditimi u konstatua se:

a- Aktualisht shoqëria **i ka paguar dhe vijon të paguajë gabim** anëtarët e këshillit mbikëqyrës, mbështetur në VKM nr. 370, datë 14.06.2006 *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të administratës së prefektit”*, i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të VKM nr. 545, datë 11.08.2011;

b- Bazuar në VKM nr. 642, datë 11.10.2005 *“Për Këshillat Mbikëqyrës të sha-ve”*, i ndryshuar, në përlllogaritjen e pagave nuk është marrë parasysh pjesëmarrja në kapital e MZHETS – në rolin e pushtetit qendror (76% të kuotave) dhe Bashkisë (34% të kuotave)-në rolin e pushtetit vendor;

c- Njëkohësisht, si në Sha “Tregu i shitjes me shumicë i fruta-perimeve, Shkodër”, ashtu edhe në sha “Tregu i shitjes me shumicë i fruta-perimeve, Vlorë”, në strukturat e Këshillave Mbikëqyrës, janë miratuar 6 anëtarë në vend të 3 të tillëve, pasi të dyja këto shoqëri bëjnë pjesë në sektorë jo-strategjik. Nga përlllogaritjet e kryera nga grupi i auditimit për vitin 2013 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2014, rezultoi se,

- Sha “Tregu i shitjes me shumicë i fruta-perimeve, Vlorë”, aktualisht paguan 6 anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, në vend të 3 të tillëve që duhet sipas legjislacionit në fuqi, duke paguar më tepër 1,135,260 lekë, ***që përbën përdorim jo efektiv të fondeve.***

- Sha “Tregu i shitjes me shumicë i fruta-perimeve, Shkodër”, aktualisht paguan 6 anëtarë, në vend të tre të tillëve, duke paguar më tepër 743,412 lekë, ***që përbën përdorim joefektiv të fondeve. Për këtë është rekomanduar që:***

Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të monitorojë:

a- Në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe strukturat menaxhuese të sha “Tregu i shitjes me shumicë i fruta-perimeve, Shkodër”, kryerjen e sistemeve përkatëse për pagesat e anëtarëve të këshillave mbikëqyrëse, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 545, datë 11.08.2011 *“Për një ndryshim në VKM nr 370, datë 14.06.2006 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të administratës së prefektit”*.

b- Strukturat drejtuese të sha “Tregu i shitjes me shumicë i fruta-perimeve, Shkodër”, për kryerjen e përlllogaritjes së saktë të pagave të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, duke konsideruar pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë të: MZHETS ~ 76% dhe Bashkisë Shkodër ~34%, në përputhje me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 *“Për Këshillat Mbikëqyrës të sha-ve”*, i ndryshuar.

c- SHA “Tregu i shitjes me shumicë i fruta-perimeve, Vlorë”, dhe SHA “Tregu i shitjes me shumicë i fruta-perimeve, Shkodër”, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Bashkinë Shkodër, të marrë masat e duhura për përcaktimin korrekt të numrit të anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrëse, në përputhje me sektorin jo-strategjik, ku bëjnë pjesë këto shoqëri, bazuar në kërkesat e VKM nr. 642, datë 11.10.2005 *“Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”*.

Brenda 3/mujorit të parë të vitit 2015.

15. Nga auditimi u konstatua se, janë 6 shoqëri anonime ku janë konstatuar anëtarë me afat emërimi më shumë se 3 vite, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, si më poshtë:

Aeroporti Nënë Tereza SHA: [REDAKTUAR] – afati i emërimit 5 vite.

Sha ALBCONTROL(ish ANTA): [REDAKTUAR] – 4 vite.

Porti detar Sarandë: [REDAKTUAR] – 5 vite.

SHA Trajtimi i studentëve Korçë: [REDAKTUAR] – 4 vite

SHA ALBMINIERA: [REDAKTUAR] – 4 vite.

SHA Prodhim Kabllo, Shkodër: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] – 4 vite ([REDAKTUAR] - i pa përditësuar në QKR), trajtuar më hollësisht në faqet 65-69 të projektraportit.

Për këtë është rekomanduar që:

SHA “Aeroporti Nënë Tereza, SHA “ALBCONTROL”, SHA “Porti detar, Sarandë”, SHA “Trajtimi i studenteve, Korçë”, SHA “ALBMINIERA”, SHA “Prodhim Kabllo, Shkodër”, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të marrë masat e duhura për ndryshimin e afateve të emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrëse, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si edhe pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, brenda afateve që kërkon Ligji nr. 9773, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Brenda 3/mujorit të parë të vitit 2015.

16. Nga auditimi u konstatua se rezultojnë 3 subjekte – shoqëri anonime, për të cilat nuk ka asnjë të dhënë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në kundërshtim me kërkesat nenit 22, të ligjit nr. 9773, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si më poshtë:

Trajtimi i studenteve Shkodër SHA; Qendra Kombëtare e Panairëve SHA; Kripa SHA, trajtuar më hollësisht në faqet 65-69 të raportit.

Për këtë është rekomanduar që:

Trajtimi i studenteve Shkodër SHA; Qendra Kombëtare e Panairëve SHA; Kripa SHA, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të marrë masat e duhura që të kryejë procedurat për regjistrim, në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Brenda 3/mujorit të parë të vitit 2015.

17. Nga auditimi u konstatua se, 6 shoqëri anonime kanë vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, neni 36/gj,pra rezultojnë të kenë afatet e emërimit të pa përditësuar të SHA Albafilm; SHA Taulantia (shoqëri në likuidim e sipër, madje këtu nuk janë pasqyruar as lëvizjet e anëtarëve, por vijnë të jenë ata të emëruar që në 2011, ndërkohë që nga informacioni i Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike, konstatohet se janë emëruar anëtarë të rinj: SHA Tipografia Ushtarake; SHA Petrol Alba; Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhës (Më datë 05.06.2014 është emëruar si anëtare [REDAKTUAR], dhe është larguar [REDAKTUAR], i cili ky i fundit vijon të mbetet i regjistruar si anëtar, në ekstraktin e kompanisë) dhe ALBPETROL SHA (ku nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike na raportohet [REDAKTUAR] si anëtare, ndërkohë që nga ekstrakti i QKR-së rezulton të jetë [REDAKTUAR]).

Për këtë është rekomanduar që:

SHA Albafilm, SHA Taulantia, SHA Tipografia Ushtarake, SHA Petrol Alba, Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhës, ALBPETROL SHA, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të marrë masat e duhura që të reflektojnë në regjistrin tregtar të dhënat sa i takon afateve të emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrëse, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Brenda 3/mujorit të parë të vitit 2015.

18. Nga auditimi i monitorimit të shoqërive (sha) nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike u konstatua se në përgjithësi për të gjitha shoqëritë nga struktura e kësaj drejtorie (megjithëse e pa plotësuar) kryhej monitorimi miratimi i llogarive vjetore të tyre. Megjithatë tre prej këtyre shoqërive, kanë krijuar shoqëri të tjera “bija”, ku zotërojnë 100% të kuotave të kapitalit aksionar dhe llogaritë vjetore të tyre nuk miratoheshin nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, por nga vetë shoqëritë “mëma”, si më poshtë:

-OST Security SHA, për ruajtjen dhe sigurinë fizike të aseteve të saj. Me Vendimin nr. 20 të Këshillit Mbikëqyrës, datë 10/11/2010 “Për krijimin e shoqërisë së ruajtjes dhe sigurisë fizike “OST SECURITY” sha”, në mbështetje të nenit 19 dhe 20, të Statutit të OST sha, është miratuar propozimi për krijimin e shoqërisë së ruajtjes dhe sigurisë fizike “OST SECURITY” sha, me kapital 100% shtetëror, me aksionar të vetëm OST sha.

-KESH Security SHA, për ruajtjen dhe sigurinë fizike të aseteve të saj. Miratimi është bërë me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 07.04.2008, ku aksionar me 100% të kuotave kapitale është KESH SHA. Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë “KESH Security” SHA ËSHTË ruajtja dhe siguria fizike.

-INTERPOST shpk. Propozimi për krijimin e kësaj shoqërie, është miratuar me Vendimin nr.45, datë 21.11.2011, “Mbi krijimin e shoqërisë Interpost shpk”. Me Urdhrin e Ministrit, me nr.61, datë 06.02.2012 “Për krijimin e shoqërisë InterPost SHPK”, u miratua krijimi i Interpost shpk dhe zotërimi i kuotave 100% të kapitalit aksionar nga POSTA SHQIPTARE sha. INTERPOST shpk, ushtron veprimtarinë *Në fushën e tregtisë* shoqëria do të kryejë: Ndërtimin e sistemeve të integruara, *në fushën e shërbimeve*: aktivitetin e shërbimeve të telekomunikacionit, lidhjes në internet dhe intranet, komunikimi video dhe audio për përdoruesin biznes dhe familjar, *në fushën e prodhimit* dhe assemblim pajisjesh të telekomunikacionit dhe informatikës dhe projektim, zhvillim, furnizim dhe mirëmbajtje e platformave software për administrim të proceseve dhe zgjidhjeve interaktive multimediale në sektorin e edukimit.

Për këtë është rekomanduar që:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes - Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike (pronar i vetëm në këto shoqëri), të kërkojë nga shoqëritë “**mëma**” OST sha, KESH sha dhe Posta Shqiptare sha, që bashkë me llogaritë vjetore të tyre çdo vit, të dorëzojë për të miratuar edhe llogaritë vjetore të shoqërive “**bija**” si: OST Security sha, KESH Security sha dhe Interpost shpk.

Brenda 6/mujorit të parë të vitit 2015.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT